



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:036238  
Datë: 30.10.2024  
Numri i dokumentit: 06370571

Ac.nr.526/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. S. Z. nga R. të cilin e përfaqëson prindi si përfaqësues ligjor e këtë me autorizim av. H. M, nga P. , sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës B. K. e S. me seli në P. për shkak të kompensimit të dëmit duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.388/15, datë 28.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit I. Z. nga R. me përfaqësues ligjor S. Z. dhe ankesa e të paditurës B. K. e S. (B... ) me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.388/15, i datës 28.09.2020, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.388/15, të datës 28.09.2020 ka vendosur si në vijim:

*PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit I. S. Z., DETYROHET e paditura B. K. e S. Në P. , që paditësit I. Z. , në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material ti paguaj shumën prej 14,620.00 euro, me kamatë vjetore sipas normës 8%, e cila do të llogaritet nga dita*

*e nxjerrjes së aktgjykimit, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.*

*Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1,500.00 euro;*

*Në emër të frikës shumën prej 1,300.00 euro;*

*Në emër të zvogëlimit të përgjithshëm jetësor shumën prej 9,500.00 euro;*

*Në emër të shëmtimit trupor shumën prej 2,000.00 euro;*

*Në emër të ndihmës së huaj shumën prej 200.00 euro;*

*Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 120.00 euro.*

*Përtej shumës së kërkesëpadisë së precizuar kërkesëpadia e paditësit REFUZOHET.*

*OBLIGOHET e paditura që paditësit përpos shumës së cekur më lartë të ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë pre 2,446.00 euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i paditësit, dhe atë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në atë mënyrë që të rriten shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material.

Gjithashtu ankesë ka paraqitur dhe pala e paditur, dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ose aktgjykimi të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e të paditurës ka paraqitur pala paditëse, me propozim që të refuzohet ankesa e palës së paditur, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit ligjor të tij, me datë 18.12.2015 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.388/15, të datës 28.09.2020, me të

cilin e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si pjesërisht të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parshtruar se nga Raporti Policor i datës 06.08.2015, është vërtetuar që aksidenti ishte shkaktuar me lëshimet e vozitësit N. O. nga R., i cili si drejtues i automjetit G... me targa ....., nuk i është përshtatur rregullave të komunikacionit në qytet, duke lëvizur me shpejtësi të pakujdesshme dhe ka lënduar këmbësorin, këtu paditësin e mitur I. Z. Në bazë të ekzaminimit të ekspertit të mjekësisë Dr. A. T., ortoped, është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime trupore – plagë shqyese në regjionin e djathtë të ballit me gërvishje të regjionit të fytyrës, gërvishje dhe ndrydhje të regjionit të bërrylit të djathtë. Si pasojë e lëndimeve ka përjetuar dhimbje fizike të të gjitha intensiteteve dhe frikë sekondare të intensitetit të lartë, të ulët dhe të mesëm. Shëmtimi trupor ekziston në shkallë të lehtë. Ushqimi i përforcuar dhe ndihma e huaj kanë qenë të domosdoshme për periudhën prej 10 ditësh. Sipas ekzaminimit të neuropsikiatrit Dr. F. D. është konstatuar se paditësi ka pësuar pengesa neuro zhvillimore të cilat kanë shkaktuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 20%. Kjo vërtetohet dhe nga super ekspertiza, e cila ka konstatuar se nga ana e paditësit vërehet një vonesë në të kuptuar, pra në zhvillim mendor, e të cilin vlerësim për shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor e ka mbështetur edhe grupi i tre ekspertëve mjekësor në ekspertizën e administruar si provë.

Gjykata e shkallës së parë vendimin për detyrimin e të paditurës për kompensimin e dëmit e ka bazuar në nenin 18.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyueshëm nga Autopërgjegjësia, ku parashihet se: *Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.*”, kurse sipas nenit 20.2 të po të njëjtit ligj, parashihet se: *Personi fizik i dëmtuar ka të drejtë të dëmshpërblimit prej dëmeve që vijnë si rezultat[...], dëmtimeve trupore apo përkeqësimit të shëndetit deri në shumën e përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji. Aktgjykimi poashtu është mbështetur në nenin 177 dhe 183 të LMD-së, kurse vendimi për kamatën në dispozitat e nenit 382 të LMD-së. Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, pasi gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë, gjegjësisht ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet nga të cilat ka rezultuar se deri te aksidenti ka ardhur ekskuzivisht nga lëshimet e drejtuesit të automjetit të pasiguar, e që kanë rezultuar me dëme jo materiale dhe materiale për paditësin. Të gjitha faktet vendimtare janë konstatuar mbi bazën e provave të administruara si në seancën e

shqyretimit kryesor, nga të cilat është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë dhe përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit që i është shkaktuar paditësit nga aksidenti në fjalë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë 06.08.2015 në R. Shkaktari kryesor me përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, ishte dejtuesi i automjetit “G...” me targa ..... , i cili automjet nuk kishte mbulesë të sigurimit. Nuk ishte kontestues që si pasojë e aksidentit, paditësi, i cili në kohën e aksidentit ishte gjashtë vjeç, pëson lëndime të lehta trupore, por me pasoja të përhershme, në formë të pengesës neuro zhvillimore që kanë ndikim në zvogëlim të aktivitetit të përhershëm jetësor.

Për më tepër, baza juridike e kërkesëpadisë, respektivisht përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit nuk është kontestuar nga e paditura, e cila me qëllim të zgjidhjes së kontestit me marrëveshje, palës paditëse i ka ofruar shumën prej 2000€ për të gjitha kategoritë e dëmit, me përjashtim të kompensimit në lartësinë e kërkuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, duke pranuar kompensimin sipas shkallës së zvogëlimit të aktivitetit jetësor prej 5%, të konstatuar në ekspertizën e datës 10.05.2018 të ekspertit N. Sh. neuropsikiatër.

Gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e fakteve kontestuese, gjegjësisht shkallës së zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit, sipas propozimit të palës paditëse ka caktuar ekspertin neuropsikiatër F.D. i cili në vlerësimin e dhënë në seancën gjyqësore të datës 02.07.2019, ka konstatuar se të paditësi zvogëlimi i aktivitetit jetësor manifestohet në shkallë 20%. Ky vlerësim është përkrahur edhe nga grupi i ekspertëve të Klinikës Psikiatrike të SSHKUK të hartuar me datë 06.11.2019 nga ekspertët: Dr. T. H. psikiatër i fëmijëve, Dr. M. P. neurologe dhe Dr. J. Rr. B., neurologe, ashtu siç rezulton nga procesverbali i seancës për shqyrtimin kryesor i datës 28.09.2020, ku në emër të grupit të ekspertëve, Dr. T. H. ka deklaruar se zvogëlimi i aktivitetit të përhershëm jetësor të paditësi është në shkallë 20%. Rrjedhimisht, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e besueshme, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që paditësit t’i kompensohet dëmi në lartësinë e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të paqëndrueshme pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi nuk ishte kontestues që automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti në komunikacion ka qenë pa mbulesë të sigurimit, ndërsa paditësi lëndime trupore ka pësuar duke mos pasur asnjë kontribut në shkaktimin e këtij dëmi. Prandaj nga këto rrethana është e qartë se e paditura ka për detyrim që paditësit t’i kompensoj dëmin dhe atë në kuptim të nenit 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 04/2-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia (LSDA), Po ashtu, gjykata drejtë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit, ku përcaktohet se: “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga

shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Në rastin konkret, dëmi jo material dhe material është vërtetuar përmes provës së besueshme – ekspertizës mjekësore, kështu detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, sipas gjetjeve të gjykatës ankimore, paraqet një vendim të drejtë dhe të ekuilibruar në mes të të mirës së shkelur dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi, si formë e satisfaksionit për paditësit. Ndërkaq, sipas vlerësimit të gjykatës ankimore shumë e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit janë adekuate me lëndimet që i ka pësuar paditësi, ndërsa lartësia e kompensimit është në pajtim të plotë edhe me praktikën gjyqësore.

Nga arsyet e parashtruara gjykata ankimore, pretendimet ankimore të ndërgjyqësve për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke i vlerësuar si tërësisht të pabazuara vendosi që ankesën ta refuzoj, ndërsa aktgjykimin e atakuar në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë, ta vërtetoj si vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet si më lart Gjykata e Apelit, duke u mbështetur në nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.526/2021 me datë 07.10.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli